

Fjalë e mbajtur e kryetarit Hivzi Islami në mbledhjen komemorative të ASHAK-ut me rastin e vdekjes së Gjelosh Gjokajt, anëtar i jashtëm i Akademisë sonë, 28. 09. 2016

Katër ditë më parë morëm lajmin e hidhur për humbjen e artistit të shquar, piktorit, grafistit, pedagogut, anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, maestro Gjelosh Gjokaj, i konsideruar si njëri nga shtyllat e zhvillimit të arteve bashkëkohore pamore te ne, artist që me vlerat dhe arritjet e krijimtarisë së tij kapërceu kufijtë e artit të Kosovës dhe atij shqiptar në përgjithësi, duke bërë emër gjithandej nga u paraqit, mbi të gjitha në Itali dhe së fundi në Gjermani ku kaloi një pjesë të jetës dhe ku ndërroi jetë më 25 shtator 2016.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë vëllain, mikun dhe kolegun tonë të dashur Gjelosh Gjokaj.

Lavdi!

Gjelosh Gjokaj kishte një rrugë të bujshme jetësore, një rrugë shtegtuese, por gjithnjë produktive krijuese, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën kolektive të shqiptarëve kudo që gjenden. Lidhjet e vazhdueshme me Kosovën, kontributi shumë i vlefshëm në edukimin e gjeneratave të para të artistëve të rinj gjatë kohës kur ishte pedagog në Degën e Arteve Figurative të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë, deri në vitin 1968 kur u shpërngul në Romë, pjesëmarrja e vazhdueshme në ekspozitat kolektive të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës, si dhe ekspozitat e pavarura të organizuara në Prishtinë na hapën udhë që ta propozonim dhe zgjidhnim anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 1996, gjë që i bëri edhe më të afërta lidhjet e tij me këtë themelatë. Në vitin 2014 Akademia jonë botoi monografinë për veprën e tij, ndërsa në fondin e Akademisë gjenden edhe tablotë e tij, midis të cilave disa të dhuruara.

Vdekja e maestros Gjelosh Gjokaj është para së gjithash humbje e familjes, e mikut, e artistit që e përfaqësoi kulturën dhe artin shqiptar denjësisht anekënd botës, e njeriut të urtë dhe dashamirës, humbje për miqtë dhe kolegët e tij në Kosovë, por edhe për ne në Akademi që e njihnim dhe e çmonim aq shumë.